

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjyquese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. L. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm, PP/II.nr. /14 të datës 03.03.2016, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit, me datë 08.02.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKTGJYKIM

## I akuzuari:

H. L., nga i ati Z. dhe e ëma K., e vajzërisë H. i lindur me 13.05.1971 në fshatin K., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, bujk, i martuar, i ati i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal .

## ËSHTË FAJTOR

Se me datë 18.11.2013, gjatë inspektimit të bërë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është hasur duke operuar ilegalisht në përpunimin e rërës dhe zhavorit, seperimi i resurseve minerale në lokacionin e fshatit K.-Prizren dhe atë në lokacionin në këto koordinata x , y , z , për të cilat koordinata nuk ka pasur leje për aktivitete të veçanta të lëshuar nga KPMM-ja.

-Këso dore kryen veprën penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së.


Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 73 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 400 € (katërqindë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) € gjobë, përkatsisht 20 (njëzetë) ditë burgim.

I akuzuari H. L., obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi i autorizuar i Kompanisë së Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë rr. " " , nr.1, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.



100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

## Arsyetim

Prokurori i Shtetit në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 450/14 të datës 03.03.2016, kundër të akuzuarit H. L. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së.

Në shqyrtimin fillestar, i akuzuari H. L. ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari H. L., ditën kritike me datë 18.11.2013, gjatë inspektimit të bërë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është hasur duke operuar ilegalisht në përpunimin e rërës dhe zhavorit, seperimi i resurseve minerale në lokacionin e fshatit K.-Prizren dhe atë në lokacionin në këto koordinata x , Y , Z = , për të cilat koordinata nuk ka pasur leje për aktivitete të veçanta të lëshuar nga KPMM-ja.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari H. L., i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfasuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe premtimin e tij se nuk do të përsërisë veprime kundërligjore, se gjatë procesit gjyqësor ka patur qëndrim korrekt para gjykatës, po ashtu gjykata mori parasysh edhe rrethanat familjare-se është është kryefamiljar dhe mbajtës i vetëm i familjes. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me rrethanat personale që i posedon i akuzuari dhe se është adekuat me përgjegjësinë e tij penale me bindje se do të arrihet qëllimi i dënimit duke përfshirë preventivën individuale dhe atë të përgjithshme, e poashtu do të ndikojnë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 463 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.




**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.479/2016, me datë 08.02.2017**

Procesmbajtësja  
Luljeta Luboteni

*Luboteni*



**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Sadije Selmani**

*Selmani*

**UDHËZIM JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.